



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. __, datë __. __.2026

“PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE AKSIONARE SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton rregullat për përbërjen, përzgjedhjen, emërimin, funksionimin, vlerësimin dhe mbikëqyrjen e këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore, si dhe organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Përhershme të Emërimit.
2. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen për të gjitha shoqëritë aksionare me kapital shtetëror, në pronësi të institucioneve qendrore dhe vendore.
3. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore është konform parashikimeve të ligjit nr.7926/1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, ndërsa numri konkret i anëtarëve për secilën shoqëri të parashikohet në statutin përkatës.
4. Kandidatët për anëtarë të këshillave mbikëqyrës përmbushin kërkesat si vijon:
 - a) përvojë në drejtim dhe menaxhim ekzekutiv;
 - b) njohuri në financë, qeverisje korporative, menaxhim risku dhe pajtueshmëri;
 - c) kompetenca teknike dhe sektoriale sipas fushës së veprimtarisë së shoqërisë;
 - ç) integritet, etikë të lartë profesionale dhe aftësi për të ushtruar funksionin në mënyrë të pavarur dhe në interesin më të mirë të shoqërisë;
 - d) mungesën e ushtrimit të funksioneve politike aktive;
 - dh) deklarin e konfliktit të interesit para dhe gjatë ushtrimit të funksionit.
 - e) aftësitë për të kontribuar në arritjen e objektivave të shoqërisë, siç është parashikuar në Letrën e Pritshmërisë nga përfaqësuesi i pronarit të pronës shtetërore. Letra e pritshmërive përcakton objektivat kryesore të kompanisë, pritshmëritë e pronarit në lidhje me performancën, rezultatet e dëshiruara të qeverisjes dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit përkatës të Emërimeve si edhe në faqen zyrtare të shoqërisë tregtare shtetërore.

5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 7926/1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar. Kandidatët e propozuar nga përfaqësuesi i pronarit të pronës shtetërore dhe nga ministri i linjës ose organi i vetëqeverisjes vendore, sipas rastit, vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Emërimeve për verifikim të përshtatshmërisë së tyre dhe përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara në këtë vendim.
6. Anëtarët e pavarur përzgjidhen përmes një procedure të hapur aplikimi dhe vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Emërimeve. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës zgjidhet nga radhët e anëtarëve të pavarur.
7. Komisioni i Përhershëm i Emërimeve vlerëson të gjithë kandidatët dhe i propozon Asamblesë së Përgjithshme listën përfundimtare të kandidatëve për emërim me justifikimin përkatës, duke siguruar që shumica e anëtarëve të emëruar të jenë anëtarë të pavarur. Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës respekton parimin e barazisë gjinore. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk pranon një kandidat të propozuar nga Komisioni i Përhershëm i Emërimit, me arsyetimin përkatës, ky i fundit propozon një kandidat të ri.
8. Anëtar i pavarur konsiderohet çdo person që:
 - a) nuk ka marrëdhënie pune ose kontraktuale me shoqërinë në 3 vitet e fundit;
 - b) nuk është i lidhur me aksionarët apo administratorët;
 - c) nuk ka interes financiar apo personal që cenon pavarësinë e tij;
 - ç) nuk ka ushtruar funksione politike në 3 vitet e fundit;
 - d) përmbush kriteret e integritetit dhe profesionalizmit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
 - e) nuk është nëpunës i administratës publike.
9. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës, si më poshtë vijon:
 - a) shpërblimi i kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës duhet të jetë afërsisht 20 për qind e pagës mujore të administratorit të shoqërisë, por jo më shumë se 100,000 lekë për shoqëritë tregtare shtetërore strategjike dhe jo më shumë se 60,000 lekë për shoqëritë tregtare shtetërore jo strategjike.
 - b) shpërblimi i anëtarëve të pavarur duhet të jetë afërsisht 70 për qind e shpërblimit të kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës;
 - c) shpërblimi i anëtarëve jo të pavarur duhet të jetë afërsisht 50 për qind e shpërblimit të kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës.

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e këshillit. Efektet financiare përballohen nga vetë shoqëria tregtare.

10. Këshilli mbikëqyrës mbledhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit dhe raporton për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë pranë përfaqësuesit të pronarit, jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Këshilli mbikëqyrës kryen vetëvlerësim vjetor dhe vlerësim të jashtëm çdo 3 (tre) vjet për shoqëritë strategjike.

11. Anëtarët e këshillave mbikëqyrës paraqesin deklaram me shkrim për mungesën e konfliktit të interesit dhe paanshmërinë e tyre, status i cili verifikohet gjatë gjithë mandatit. Deklarimi dhe verifikimi i konflikteve të interesit kryhet nga Komisioni përkatës i emërimit para emërimit dhe monitorohet gjatë gjithë mandatit nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast konflikti i interesit, anëtari përjashtohet nga vendimmarrja përkatëse dhe në rast përsëritjeje apo shkeljeje të rëndë, shkarkohet.

12. Këshilli mbikëqyrës harton një raport vjetor mbi:

- a) performancën e shoqërisë;
- b) arritjen e objektivave;
- c) veprimtarinë e këshillit;
- ç) shpërblimet e anëtarëve.

Raporti publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë tregtare shtetërore dhe në faqen zyrtare të Komisionit të Përhershëm të Emërimit.

13. Pranë Ministrisë përgjegjëse për ekonominë ngrihet Komisioni i Përhershëm i Emërimit, i cili është përgjegjës për organizimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të këshillave mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore, sipas fushës së përgjegjësisë. Ky komision do të vlerësojë kandidatët për këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare në pronësi shtetërore të të gjithë institucioneve me përjashtim të shoqërive që janë në pronësi të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, si edhe për ato shoqëri që janë pronësi të organeve të vetëqeverisjes vendore.

14. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Emërimit në ministrinë përgjegjëse për ekonominë emërohen me urdhër të titullarit të institucionit me përbërjen si më poshtë:

- a) 4 (katër) anëtarë të pavarur, ekspertë me përvojë të dëshmuar në fusha si qeverisja korporative, financat, auditimi, e drejta tregtare, menaxhimi i riskut ose fusha të ngjashme, të cilët përzgjidhen nëpërmjet një procedure të hapur aplikimi, bazuar në shpalljen e publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Këta anëtarë kanë një mandat 3 vjecar.
- b) 1 (një) përfaqësues i nivelit të lartë drejtues me rotacion nga ministria që zhvillon politikat sektoriale;
- c) 1 (një) përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

Me shumicë të thjeshtë votash, komisioni zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të pavarur.

15. Pranë Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë ngrihet Komisioni i Përhershëm i Emërimit, i cili është përgjegjës për organizimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të këshillave mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore, sipas fushës së përgjegjësisë. Ky komision do të vlerësoj kandidatët për këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare në pronësi shtetërore ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën.

16. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm në ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë emërohen me urdhër të titullarit të institucionit me përbërjen si më poshtë:

- a) 4 (katër) anëtarë të pavarur, ekspertë me përvojë të dëshmuar në fusha si qeverisja korporative, financat, auditimi, e drejta tregtare, menaxhimi i riskut ose fusha të ngjashme, të cilët përzgjidhen nëpërmjet një procedure të hapur aplikimi, bazuar në shpalljen e publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Këta anëtarë kanë një mandat 3 vjeçar.
- b) 1 (një) përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë.
- c) 1 (një) përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

Me shumicë të thjeshtë votash, komisioni zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të pavarur.

17. Pranë Agjencisë përgjegjëse për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore ngrihet Komisioni i Përhershëm i Emërimit, i cili është përgjegjës për organizimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të këshillave mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore, sipas fushës së përgjegjësisë. Ky komision do të vlerësoj kandidatët për këshillat mbikëqyrës të sh.a. në pronësi shtetërore të organeve të pushtetit vendor.

18. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Emërimit në Agjencinë përgjegjëse për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore emërohen me urdhër të titullarit të institucionit me përbërjen si më poshtë:

- a) 4 (katër) anëtarë të pavarur, ekspertë me përvojë të dëshmuar në fusha si qeverisja korporative, financat, auditimi, e drejta tregtare, menaxhimi i riskut ose fusha të ngjashme, të cilët përzgjidhen nëpërmjet një procedure të hapur aplikimi, bazuar në shpalljen e publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Këta anëtarë kanë një mandat 3 vjeçar.
- b) 1 (një) përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;
- c) 1 (një) përfaqësues me rotacion nga Bashkia që ushtron tagrin e pronarit për shoqërinë përkatëse.

Me shumicë të thjeshtë votash, komisioni zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të pavarur.

19. Anëtarët e Komisionit duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

- a) të kenë integritet të lartë profesional dhe etik;
- b) të jenë ekspertë të spikatur në fushën e menaxhimit dhe biznesit;

- c) të mos jenë në konflikt interesi me shoqëritë objekt vlerësimi;
- ç) të mos ushtrojnë funksione politike aktive;
- d) të plotësojnë kriteret e pavarësisë të përcaktuara në këtë vendim;
- dh) të ruajnë konfidencialitetin mbi të dhënat që do të shqyrtojnë.

20. Komisioni ka këto përgjegjësi:

- a) përcaktimin e kriterëve për çdo pozicion vakant në këshillat mbikëqyrës;
- b) organizimin dhe administrimin e thirrjeve të hapura për aplikime;
- c) shqyrtimin, vlerësimin dhe intervistimin e kandidatëve;
- ç) propozimin e kandidatëve për emërim;
- d) vlerësimin e anëtarëve të emëruar të këshillave mbikëqyrës dhe i propozon Asamblesë së Përgjithshme largimin e tyre në rastet kur anëtarët e këshillave ligjore nuk veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- dh) mbajtjen dhe përditësimin e një regjistri të kandidatëve të kualifikuar;
- e) monitorimin e përbërjes së këshillave mbikëqyrës në nivel portofoli.

21. Komisioni mbështetet nga sekretariati teknik pranë institucionit përkatës që ngre komisionin.

Sekretariati Teknik mbështet dhe dokumenton punën e Komisionit, duke përfshirë administrimin e procedurave të përzgjedhjes, mirëmbajtjen e dokumentacionit përkatës dhe funksionimin e faqes zyrtare të Komisionit përkatës të Emërimeve.

Sekretariati Teknik publikon vendet e lira, letrat e pritshmërive, raportet vjetore dhe informacione të tjera relevante në lidhje me veprimtarinë e këshillave mbikëqyrës dhe procedurat e emërimit.

Përbërja dhe funksionimi i detajuar i Sekretariatit Teknik përcaktohet në rregulloren e brendshme të Komisionit përkatës.

22. Kryetari i Komisionit të Përhershëm të Emërimit përfiton shpërblim mujor në masën 100,000 (njëqind mijë) lekë, ndërsa anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Emërimit përfitojnë shpërblim mujor në masën 70,000 (shtatëdhjetë mijë) lekë.

Sekretariati Teknik përfiton shpërblim mujor në masën 25 000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.

Shpërblimi mujor i kryetarit, anëtarëve dhe sekretariatit teknik të Komisionit të Përhershëm të Emërimit përballohen nga buxheti i institucionit përkatës që ngre Komisionin.

23. Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës dhe të komisioneve të përhershme të vlerësimit:

- a) funksionarët politikë;
- b) drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore dhe administrator të shoqërive tregtare;
- c) persona që kanë konflikt interesi, në kuptim të ligjit nr.23/2026, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike";
- ç) punonjës të organeve qendrore apo vendore që kryejnë funksione auditimi.

24. Funkionarë politikë konsiderohen ministrat, zëvendësministrat, deputetët, drejtuesit e lartë të partive politike, anëtarët e organeve drejtuese të tyre, si dhe këshilltarët politikë të kabineteve ministrore. Këta persona nuk mund të emërohen si anëtarë të këshillave mbikëqyrës. Emërimi i tyre lejohet vetëm pas përfundimit të një periudhe prej 3 (tre) vitesh nga ushtrimi i funksionit.
25. Këtij vendimi i nënshtrohen edhe shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe të gjitha shoqëritë me kapital shtetëror në pronësi të institucioneve qendrore dhe vendore.
26. Brenda 6 muajve nga ngritja e Komisioneve të Përhershme të Emërimit, këto komisione kryejnë vlerësimin e anëtarëve ekzistues të këshillave mbikëqyrës. Në rast se anëtarët ekzistues nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Përhershëm i Emërimeve fillon procedurën për zëvendësimin e tyre. Anëtarët ekzistues që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, vazhdojnë të jenë anëtarë të këshillave mbikëqyrës deri në përfundimin e mandatit të tyre. Emërimet e reja bëhen sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.
27. Ministri përgjegjës për ekonominë miraton me urdhër rregullat që rregullojnë:
- organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Përhershme të Emërimit;
 - procedurat për përzgjedhjen, vlerësimin dhe emërimin e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme të Emërimit;
 - funksionimin e Sekretariateve Teknike dhe çështjet e tjera procedurale të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
28. Ministria përgjegjëse për ekonominë vlerëson performancën e Komisioneve të Përhershme të Emërimit dhe anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, çdo 3 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
29. Vendimi nr. 570, datë 3.10.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.
30. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha institucionet shtetërore qendrore dhe vendore që kanë në pronësi shoqëri tregtare shtetërore, si dhe agjencia përgjegjëse për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama